

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 471 Prot.

Tiranë, më datë 11.10.2024

VENDIM

Nr. 417, datë 11.10.2024


Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 11.10.2024:

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës së **Z. Ardit Ahmetli** për paisje me Licencë individuale për veprimtarinë arkeologjike në kategorinë: A1. Vëzhgim arkeologjik (Survey);
2. Mosmiratimin e kërkesës **Z. Ardit Ahmetli** për paisje me Licencë individuale për veprimtarinë arkeologjike në kategorinë: A2. Sondazhe arkeologjike, pasi nuk plotëson kushtet sipas përcaktimeve në nenin 3/2/b të VKM Nr. 793, datë 7.10.2020 “Për përcaktimin e kushteve të posaçme e të kritereve të licencimit, dokumenteve shoqëruese dhe procedurave për shqyrtimin ose revokimin e licencës për veprimtarinë arkeologjike dhe veprimtarinë arkeologjike nëmuore”;
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
4. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrative.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR  
Sokol ISMAILI



KRYETAR  
Blendi GONXHJA